Kronikë

Tiranë/ Iu gjetën armë dhe emblema policie, në pranga 41-vjeçari (EMRI)

Një 41-vjeçar është arrestuar nga blutë e kryeqytetit pasi në makinë iu gjet një thikë, ndërsa në shtëpi iu gjetën 2 armë zjarri, municion luftarak dhe emblema policie

Redaksia
6 Prill, 10:31 | Përditësimi: 6 Prill, 10:51

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Tiranë- Një 41-vjeçar është arrestuar nga blutë e kryeqytetit pasi në shtëpinë e tij ofeicerët gjetën 2 armë zjarri, municion luftarak dhe emblema policie.

Ndërsa gjatë kontrollit në makinën e Saimir Allmuçës , në rrugën e Dibrës, efektivët gjetën një thikë.

Armët, municioni dhe stemat e policisë u sekuestruan si provë materiale.

LEXO EDHE:
Jonid Jorgji: Po të zgjoheshim nesër në një Shqipëri 'Gjigande' përmes kulturës dhe inovacionit

Operacioni u kodua *"The Holder"*.

Njoftimi i policisë:

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 4, në kuadër të veprimeve për goditjen e veprimtarive të paligjshme në të gjitha fushat e shfaqjes së saj, bazuar në inteligjencën policore, organizuan dhe finalizuan operacionin policor " The Holder" si rezultat i të cilit u arrestua shtetasi S. A., 41 vjeç, banues në Tiranë.

Gjatë operacionit, në Rrugën e Dibrës, shërbimet e Policisë kanë ndaluar automjetin me drejtues shtetasin S. A. Gjatë kontrollit të automjetit, iu gjet e iu sekuestrua një armë e ftohtë(thikë).

Më tej, gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë, gjetën e sekuestruan 2 armë zjarri(pistoletë dhe pushkë), 1 armë sportive, 1 armë e ftohtë, municion luftarak dhe emblema policie.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: arme zjarri | Saimir Allmuça | Tirane

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Produkte me pesticide, sa besim keni te siguria ushqimore në Shqipëri?
6 Prill, 08:55

Shumë pak | Mesatar | Kam besim

Lajme të tjera

'Berisha, kolaterali politik më i madh i Edi Ramës', Lapardhaja: Voton Saliun në Tiranë e Elbasan, të futet Meta në Parlament
6 Prill, 17:52

Skënder Gega rigjen një derbi, paralajmëron Tiranën: Duhet të jemi agresiv për maksimumin
6 Prill, 16:46

Derbi me Partizanin për 'jetë a vdekje', Shkëmbi: Kemi bërë shumë ndere, pres fitoren
6 Prill, 16:09

Mbi 1500 gjoba gjatë një jave, Rrugorja në Tiranë bën bilancin: 26 shoferë të arrestuar
6 Prill, 15:22



Pashk Përvathi rivjen me një ekspozitë me 50 punë për detin, në 'Galeri +' gjatë gjithë muajit
Blerina Goce
6 Prill, 15:10

Kamëz/ I morën 300 mijë lekë një të miture për mos t'i publikuar foto personale, 3 të arrestuar (EMRI)
6 Prill, 14:50

Akuzohet për kanosje e shpërdorim detyre, arrestohet polici i Rinasit! Para dy ditësh kërcënoi 2 persona (EMRI)
6 Prill, 14:31

Tinka Kurti 'braktiset' në një shtëpi të moshuarish, aktorja e madhe: Tragjedi që erdha këtu, por ka njerëz të mrekullueshëm
6 Prill, 12:52

Tiranë/ Kishin përshtatur lokalet për lojëra fati, 3 të arrestuar, një në kërkim (VIDEO)
6 Prill, 12:38

Tiranë/ Zjarr në katin e tretë të një banese në Shkozë! Vetëm dëme materiale
6 Prill, 10:24

Mashtrimet me vizat/ Ambasada e SHBA thirrje qytetarëve: Shmangni konsulencat që ofrojnë shërbim në këmbim të parave! Nëse plotësojnë formularin tuaj gabim, jeni ju përgjegjës
6 Prill, 09:56

Onkologjiku edhe në 'filtrin' e të huajve! Mjekët rajonalë: Problem ilaçet dhe pajisjet
Joana Preja
5 Prill, 19:52

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje